

V E N D I M
Nr.18, datë 11.1.1993

**PËR NDRYSHIMIN DHE LIBERALIZIMIN E DISA ÇMIMEVE E TARIFAVE TË
ARTIKUJVE TË SHPORTËS**

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Çmimet dhe tarifat e disa artikujve të shportës, të miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.324, datë 24.7.1992, ndryshohen sipas pasqyrës që i bashkëngjitet këtij vendimi.
2. Liberalizohen çmimet e artikujve vaj vegjetal, sheqer, oriz dhe sapun rrobash.
3. Për grup-artikujt, çmimet dhe tarifat e të cilave shumëfishohen, si barnat, qiratë e banesave dhe librat shkollorë të arsimit 8 vjeçar e të mesëm dhe të fletoreve, ministritë përkatëse, me miratim të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, u njoftojnë subjekteve të interesuara çmimet e reja, para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
4. Për grup-artikujt dru zjarri, qymyrguri, barna, vajguri, ngrohjen e përqëndruar të banesave, transportin e udhëtarëve, si dhe për librat shkollorë të arsimit 8 vjeçar e të mesëm dhe të fletoreve, diferencat ndërmjet shpenzimeve dhe çmimeve e tarifave të miratuara me këtë vendim, subvencionohen nga buxheti i shtetit, për sasi të që shkojnë, vetëm për popullsinë.
Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, në bashkëpunim me ministritë e tjera të interesuara, i propozojnë Këshillit të Ministrave masën e subvencioneve përkatëse.
5. Për artikujt, çmimet dhe tarifat e të cilëve ndryshohen sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, diferencat ndërmjet çmimeve të reja dhe atyre të mëparshme derdhen detyrimisht në buxhetin e shtetit, për sasi të që do të jenë gjendje pranë ndërmarrjeve shtetërore përkatëse dhe njërive të tregtisë, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
Organet përkatëse të pushtetit lokal të kontrollojnë dhe të marrin masa për kryerjen e rregullt të inventarizimeve, sistemimin e diferencave të çmimeve dhe derdhjen e tyre në buxhet.
6. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit që, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, të përcaktojë çmimin e shitjes së grurit dhe të miellit që shkon për fshatin, në përputhje me çmimin e pandryshuar të bukës masive, si dhe me vendin e dorëzimit të tyre.
7. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë dhe ministritë e tjera të interesuara nxjerrin udhëzimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi.
8. Pika 6 e vendimit të Këshillit nr.324, datë 24.7.1992 "Për ndryshimin e çmimeve të disa artikujve e tarifave që nuk liberalizohen", si dhe çdo dispozitë tjetër që vjen në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen.
9. Çmimet e barnave do të zbatohen nga data 1.2.1993, kurse qiratë e banesave nga data 1.3.1993.

Ky vendim hyn në fuqi më 16 janar 1993.

ZV.KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Kopliku